



INSTITUTI ALB-SHKENCA

Tiranë – Prishtinë – Shkup

dhe

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

me mbështetje të

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME

DHE TË DIASPORËS

dhe të

MINISTRISË SË ARSIMIT, TË SHKENCËS,

TË TEKNOLOGJISË E TË INOVACIONIT

organizojnë



TAKIMIN XXI VJETOR NDËRKOMBËTAR
SHKENCA:
PËRGJEGJËSI DHE
E MIRË PUBLIKE
PRISHTINË, 16-17 TETOR 2026



Në shekullin XXI, shkenca nuk është vetëm fushë e kërkimit dhe e zbulimit, por një nga forcat kryesore që përcakton zhvillimin e shoqërisë dhe të ardhmen e njerëzimit. Përparimet shkencore dhe teknologjike kanë krijuar mundësi të jashtëzakonshme për përmirësimin e jetës, por njëkohësisht kanë ngritur çështje të mëdha etike, shoqërore, ekonomike dhe mjedisore. Prandaj, shkenca nuk mund të vlerësohet vetëm sipas asaj që arrin të zbulojë, por edhe sipas mënyrës se si njohuritë e saj përdoren, kujt i shërbejnë dhe çfarë përgjegjësie marrin studiuesit, institucionet dhe shoqëria për pasojat e tyre.

Në një botë të ndërlidhur në kohë reale, të përballur me ndryshimet klimatike, pabarazinë në qasjen ndaj dijes, dobësimin e standardeve etike dhe përhapjen e informacionit të pasaktë e të manipuluar, shkenca nuk mund të qëndrojë e mbyllur brenda laboratorëve, universiteteve dhe botimeve akademike. Ajo duhet të jetë e hapur, e përgjegjshme dhe në shërbim të së mirës publike.

Nën temën bosht “Shkenca: përgjegjësi dhe e mirë publike”, Takimi XXI Vjetor Ndërkombëtar synon të mbledhë studiues, akademikë, profesionistë dhe ekspertë nga hapësira shqiptare dhe diaspora për të paraqitur rezultate kërkimore, për të shkëmbyer dije dhe për të shqyrtuar rolin e shkencës në zhvillimin shoqëror, ekonomik, kulturor dhe kombëtar.

Tema bosht shtjellohet përmes katër paneleve tematike, të cilat e trajtojnë përgjegjësinë shkencore në marrëdhënie me shoqërinë dhe identitetin, qeverisjen dhe zhvillimin, teknologjitë e së ardhmes, si dhe shëndetin, arsimin, mjedisin dhe qëndrueshmërinë.

STRUKTURA E SEANCËS PLENARE DHE E PANELEVE TEMATIKE

PANELI TEMATIK 1

SHOQËRIA, GJUHA, KULTURA DHE IDENTITETI NË EPOKËN DIGJITALE

Shkenca përgjegjësi publike në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, të kulturës, të identitetit, të komunikimit dhe të kohezionit shoqëror në epokën digjitale

Përfshin:

Gjuhësi dhe letërsi ▪ Histori dhe kulturë ▪ Media dhe komunikim ▪ Sociologji ▪ Psikologji ▪ Filozofi ▪ Antropologji ▪ Arte

PANELI TEMATIK 2

QEVERISJA, E DREJTA, EKONOMIA DHE POLITIKAT PUBLIKE

Dija shkencore në shërbim të institucioneve të qëndrueshme, të sundimit të së drejtës, të zhvillimit ekonomik dhe të politikave publike të mbështetura në dëshmi

Përfshin:

Juridik ▪ Ekonomi ▪ Menaxhim ▪ Financa ▪ Administratë publike ▪ Shkenca politike ▪ Marrëdhënie ndërkombëtare ▪ Sipërmarrje dhe politika zhvillimore

PANELI TEMATIK 3

INOVACIONI, SHKENCA DHE TEKNOLOGJITË PËR TË ARDHMEN

Inovacioni i përgjegjshëm, inteligjenca artificiale, transformimi digjital dhe teknologjitë e së ardhmes në shërbim të njeriut dhe të shoqërisë

Përfshin:

Teknologji informacioni ▪ Inteligjencë artificiale ▪ Inxhinieri ▪ Matematikë ▪ Shkenca natyrore ▪ Arkitekturë ▪ Siguri kibernetike ▪ Robotikë

PANELI TEMATIK 4

SHËNDETI, MJEDISI, ARSIMI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Shkenca në shërbim të mirëqenies njerëzore, të arsimit cilësor, të mbrojtjes së mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm

Përfshin:

Mjekësi ▪ Infermieri ▪ Shëndet publik ▪ Farmaci ▪ Edukim dhe pedagogji ▪ Bujqësi ▪ Mjedis ▪ Energji ▪ Zhvillim i qëndrueshëm

Panelet tematike krijojnë kornizën ndërdisiplinore të Takimit XXI, ndërsa konferencat shkencore paralele mundësojnë paraqitjen dhe diskutimin e punimeve sipas fushave përkatëse

KONFERENCAT SHKENCORE PARALELE

FILOLOGJIA, HISTORIA DHE KULTURA

DREJTËSIA

BUJQËSIA DHE AGROBIZNESI

EKONOMIA DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

SHKENCAT E NATYRËS DHE MJEDISI

MJEKËSIA DHE SHËNDETËSIA PUBLIKE:

**INXHINIERIA DHE
TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMEVE**

SHKENCAT SHOQËRORE DHE POLITIKE

**Është paraparë paraqitja e kërkesës për akreditimin e konferencave në odat
përkatëse**

OBJEKTIVAT KRYESORE TË TAKIMIT XXI

- Të afirmojë shkencën si përgjegjësi, si vlerë shoqërore dhe si e mirë publike;
- Të bashkojë kapacitetet shkencore shqiptare brenda hapësirës shqiptare dhe në diasporë, përtej kufijve institucionalë e shtetërorë;
- Të lidhë kërkimin shkencor me nevojat konkrete të shoqërisë përmes katër paneleve tematike dhe qasjeve ndërdisiplinore;
- Të forcojë bashkëpunimin universitar, kërkimor dhe profesional, si dhe partneritetet ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm dhe integrim evropian.

THIRRJE PËR PUNIME / CALL FOR PAPERS

Instituti Alb-Shkenca dhe Universiteti i Prishtinës ftojnë studiuesit, akademikët, profesionistët, ekspertët dhe studentët e studimeve të doktoratës që të paraqesin punime shkencore në Takimin XXI Vjetor Ndërkombëtar, i cili do të mbahet në Prishtinë, më 16–17 tetor 2026, nën temën bosht “Shkenca përgjegjësi dhe e mirë publike”.

Punimet duhet të lidhen me temën bosht dhe të vendosen në njërin nga katër panelet tematike: (1) Shoqëria, gjuha, kultura dhe identiteti në epokën digjitale; (2) Qeverisja, e drejta, ekonomia dhe politikat publike; (3) Inovacioni, shkenca dhe teknologjitë për të ardhmen; ose (4) Shëndeti, mjedisi, arsimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Brenda panelit të zgjedhur, punimi mund të paraqitet në konferencën shkencore paralele që i përgjigjet fushës së tij.

Mirëpritën veçanërisht punimet origjinale që paraqesin rezultate të reja kërkimore, qasje ndërdisiplinore, analiza krahasuese dhe zgjidhje të mbështetura në dëshmi. Çdo punim duhet të tregojë qartë jo vetëm risinë shkencore, por edhe rëndësinë e tij për dijen, shoqërinë dhe të mirën publike.

DËRGIMI I PUNIMEVE

Përmbledhjet duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Përmbledhja duhet të dorëzohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze;
- Secili version i përmbledhjes duhet të përmbajë 500 – 800 fjalë dhe 3 – 5 fjalë çelës;
- Përmbledhja e punimit duhet të përmbajë: titullin, autorin kryesor, bashkautorët dhe adresat e tyre; dhe duhet të paraqesë qëllimin e punimit, metodën e përdorur, rezultatet e përfuara, si dhe përfundimet kryesore.
- Përmbledhja e punimit duhet të formatohet sipas rregullave të botimeve të IASH, që mund të shihen në faqen e Takimit në: <http://iash-takimet.org>
- Regjistrimi dhe dorëzimi i përmbledhjeve/abstrakteve bëhen online vetëm nëpërmjet sistemit ALPA në: <http://alpa.mali-it.eu/tv2026>
- Përmbledhjet e punimeve do t'i nënshtrohen rishikimit shkencor dhe do të publikohen në Librin e Përmbledhjeve–Book of Abstracts të Takimit XXI
- Pas Takimit, autorët mund t'i dorëzojnë punimet e plota për shqyrtim në revistën shkencore AKTET (ISSN 2073-2244) që del që nga 2007. Punimet do t'i nënshtrohen recensimit shkencor të dyfishtë anonim dhe vetëm ato që plotësojnë kriteret shkencore e redaksionale do të pranohen për botim.
- Afatet e rëndësishme, udhëzimet dhe formatet e dorëzimit i gjeni në faqen zyrtare të Institutit Alb-Shkenca: <http://iash-takimet.org>

DATA ME RËNDËSI

- Afati i fundit për dorëzimin e përmbledhjeve: 5 shtator 2026
- Vlerësimi shkencor i përmbledhjeve: 6 – 15 shtator 2026
- Njoftimi për pranimin ose kërkesën për përmirësim: deri më 18 shtator 2026
- Dorëzimi i versionit përfundimtar të përmbledhjes: 23 shtator 2026
- Pagesa e pjesëmarrjes në Takim: deri më 25 shtator 2026
- Publikimi i programit paraprak: 30 shtator 2026
- Publikimi i programit përfundimtar: 5 tetor 2026
- Mbajtja e Takimit XXI: 16-17 tetor 2026
- Dorëzimi i punimit të plotë për revistën AKTET: 30 nëntor 2026

TARIFA E PJESËMARRJES DHE TË DHËNAT BANKARE

- Për pjesëmarrësit: 30 €
- Për studentët në Master dhe Doktoratë: 10 €

ADRESAT BANKARE:

Për pjesëmarrësit nga Kosova	Banka Kombëtare Tregtare, Kosovë Nr. i llogarisë: 1901378968031154
Për pjesëmarrësit nga Shqipëria	BKT-Tiranë për Institutin Alb-Shkenca Nr. llogarisë: 507360001 IBAN: AL8420511571360001CLTJCFEURA SWIFT: NCBAALTX
Për pjesëmarrësit nga Maqedonia e Veriut	Banka: Banka Komerciale, Shkup Nr. i llogarisë: 3000000004294905

KËSHILLI ORGANIZUES DHE SHKENCOR

Kryetarë

Gentian Zyberi, Norvegji
Ali Caka, Kosovë

Nënkryetarë

Eshref Januzaj, Gjermani
Fatos Ylli, Shqipëri
Ardian Maçi, Shqipëri
Zeqirja Neziri, Maqedoni e Veriut

Koordinator i Takimit XXI

Vehbi Neziri, Kosovë

Anëtarë nderi të Institutit Alb Shkenca

Niko Qafoku, SHBA, Kryetar Nderi i IASH-it
Sami Repishti, SHBA (†)
Emil Lafe, Shqipëri
Jahja Kokaj, Kosovë
Shpresa Hoxha, Kosovë
Nebi Caka, Kosovë

Anëtarë

Alketa Hoxha, Shqipëri	Musa Rizaj, Kosovë
Arjana Ylli, Shqipëri	Mustafa Ibrahim, Maqedoni e Veriut
Bajram Berisha, Kosovë	Muhamet Aliu, Kosovë
Bashkim Ziberi, Maqedoni e Veriut	Naser Peci, Kosovë
Besnik Dobi, Shqipëri	Neki Frashëri, Shqipëri
Edlira Birko, Shqipëri	Nurten Deva, Kosovë
Edlira Sadiku, Shqipëri	Nysret Musliu, Austri
Enver Hamiti, Kosovë	Petraq Papajorgji, Shqipëri
Evan Roço, Shqipëri	Ramadan Dervishi, Kosovë
Fetah Podvorica, Kosovë	Roza Allabashi, Austri
Florije Tahiri, Kosovë	Vlora Podvorica, Kosovë
Kristaq Jorgo, Shqipëri	Sead Ujkani, Kosovë
Lulzim Dragidella, Gjermani	Shahin Berisha, SHBA
Lluka Qafoku, Shqipëri	Shpresa Tafaj (Caslli), Shqipëri
Mentor Hamiti, Maqedoni e Veriut	Visar Berisha, SHBA
Muhabere Maliqi, Kosovë	